

**VENDIM**  
**Nr.808, datë 27.12.2005**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË E  
ARSIMIT DHE TË SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 280 000 000 (dyqind e tetëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e punonjësve mësimorë të sistemit parauniversitar.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë për politikatat e pagave, miratuar në buxhetin e vitit 2005.
3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**